



Nr. 318 Rep.
Nr. 76 Kol.

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 23/01/2020 para meje noteres Ardjana A.Mediu, me seli ne adresen: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 7, Tiranë, u paraqitën personalisht palët kontraktuese si më poshtë:

SHITËSI

Z.Ardian Zykej, i datëlindjes 16.08.1970, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar prej meje me Letërnjoftim me Nr.Personal H00816134J.

(nga këtu e më poshtë referuar si "Shitësi");

dhe

Z.Daniel Tufa, i datelindjes 26.09.1980, lindur dhe banues ne Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar prej meje me leternjoftimit Nr. 029873037 dhe nr. Personal I00926040J

(nga këtu e më poshtë referuar si "Blerësi")

Neni 1

Objekti i Kontratës

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja nga Shitësi tek Blerësi e kuotës që përfaqëson 25 % (njetzet e pese përqind) të kapitalit që Shitësi zotëron në shoqërinë "NEW FARI" Sh.p.k, dhe regjistrimi i këtij kalimi në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

- 2.1 Çmimi total i shitjes së kuotes që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është **50 000 Euro** (pesëdhjetë mijë).

Neni 3

Mënyra e Pagesës

- 3.1 Çmimi i shitjes së kuotës i përcaktuar në vlerën prej **50 000 Euro** (pesëdhjetë mijë) do të likujdohet si më poshtë vijon:
- Vlera prej **50 000 Euro** (pesëdhjetë mijë) do të likujdohet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë bankare të Shitësit e ndare ne keste mujore prej **2000 Euro** (dy mije) secili kest.
 - Me likujdimin total te cmimit te shitjes prej **50 000 Euro** (pesëdhjetë mijë), Shitesit detyrohet te deklaroje perpara noterit publik perfitimin prej tij te cmimit total te shitjes se 25 % te kuotes dhe me mandatet bankare bashkengjitur ti depozitoje ato nepermjet administratorit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Detyrimet e Shitësit

- 4.1 Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 2, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes se 25 % kuotës se tij në Shoqërinë "NEW FARI" Sh.p.k.

- 4.2 Shitësi pranon që kalimi i pronësisë mbi kuotat objekt i kësaj Kontrate të regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, pavarësisht mënyrës së likuidimit të çmimit të shitjes.
- 4.3 Shitësi garanton se kuota, e cila shitet me këtë kontratë, nuk është e lënë peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barrë dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi të.
- 4.4 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai ka mbi kuotën objekt i kësaj kontrate.

Neni 5
Detyrimet e Blerësit

- 5.1 Blerësi do të likujdojë çmimin e shitjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 3, pika 3.1 të kësaj kontrate.
- 5.2 Blerësi do të marrë të gjitha masat për të rregjistruar transferimin e kuotës që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 5.3 Blerësi fiton të drejta dhe detyrime mbi kuotën objekt i kontratës menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate. Detyrimet që kanë lindur përpara nënshkrimit të kësaj kontrate janë në ngarkim të Shitësit.

Neni 6
Konfigurimi pas Shitjes se Kuotave

- 6.1 Pas shitjes se kuotave konfigurimi i kuotave të Shoqërisë "NEW FARI" Sh.p.k do të jetë:
Ortaku **Ardian Zyka** bëhet zotëruar i 75 % të kuotës.
Ortaku **Daniel Tufa** bëhet zotëruar i 25 % të kuotës

Neni 7
Mosmarrëveshjet

- 7.1 Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim nga të dy palët, në rast të kundërt do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8
Gjuha e Kontratës dhe Hyrja në Fuqi

- 8.1 Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale, dhe pasi iu lexua palëve, u nënshkrua rregullisht prej tyre në prezencën time. Akti nënshkruhet dhe prej meje Noteres.
- 8.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

Z. Ardian Zyka

Ardian Zyka

BLERËSI

Z. Daniel Tufa

DANIEL TUF

NOTERE

Ardjana A. MEDIU

[Signature]